



|  |                               |                               |                               |                     |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Punijeno/Prodato<br>Received/Delivered | 10 - 11                       | 2020                          | 0                             | viti<br>god<br>year |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jedimca<br>Org./Unit                 | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |                     |
| SKIMSHK  | 2541/2020                     |                               | 113                           |                     |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.Nr. 274/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi - Bajraktari, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 274/2020, të datës 17.09.2020, të parashtruar nga ankuesi ██████████, me adrese Rruga „Adem Jashari”, Nr. 150, Komuna e Shtimes, kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike “Shkelje e drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.11.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A. Nr.274/2020 e datës 17.09.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████

**A r s y e t i m**

Ankuesi ██████████ i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në pozitën „Zyrtar i lartë për Gjeokimi”, në Agjencinë Gjeologjike të Kosovës, sipas Akt Emërimit pa afat të datës 31.03.2016, me koeficient shtatë (7), ka parashtruar kërkesë me datë 09.09.2020 me numër protokollit 1336 për rritjen e koeficientit të pagës tek U.D. i Sekretari i Përgjithshëm dhe Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Menaxheres së Personelit më datë 10.09.2020 ka parashtruar kërkesë për harmonizim të pagës me numër protokollit 1350 në Departamentin për Administrimin e Shërbimit Civil në MPB, të cilët me datë 15.09.2020 i kthejnë përgjigje se lidhur me këtë çështje përgjegjëse për menaxhimin dhe sistemimin në vendet e tyre të punës të nëpunësve civile është institucioni respektivisht në këtë rast MZHE .

Ankuesi më datë 17.09.2020, parashtron ankesë me numër protokollit 1808/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore për harmonizimin e koeficientit.





Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, për përgjigje në ankesë me datë 22.09.2020, ndërsa me datën 02.10.2020. Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me provat e bashkangjitura .

**Administrimi i Provave:** Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 274/2020 e parashtruar më datë 17.09.2020, me numër protokollit 1808/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 10.09.2020 në MPB; Konkursi i datës 12.01.2016; Akt Emërimi i datës 30.03.2016; Vendimi i datës 29.03.2016; Pershkrimi i detyrave të punës; Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë; Përgjigje në kërkesë e datës 11.09.2020; e- maili i datës 05.05.2020; Propozimi për klasifikimin e vendeve të punës;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit ██████████, është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga koeficienti shtatë (7), në koeficient tetë (8), dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara në ligj, sepse në baze të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi është punësuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit përmes procedurës së rekrutimit respektivisht përmes konkursit të jashtëm të shpallur datën 12.01.2016, për pozitën e lire të punë „Zyrtar i lartë për Gjeokimi“, me koeficient shtatë (7), në Shërbimin Gjeologjike të Kosovës, me numër të referencës ST/2310/JP00017133, pas marrjes së autorizimit nga DASHC/MAP, të datës 08.01.2016, ku edhe në autorizim ka qene koeficienti (7), .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu ka konstatuar se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Ministria e Zhvillimit Ekonomik i ka ofruar ankuesit Aktin e emërimit për nënshkrim me kushtet e punësimit për këtë pozitë, ku njëra ndër kushtet ka qenë edhe koeficienti 7, të cilin Akt Emërim ankuesi e ka nënshkruar me datë 31.03.2016 për pozitën „Zyrtar i lartë për Gjeokimi“, në Shërbimin Gjeologjike të Kosovës, me koeficient shtatë (7). Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik lidhur me kompensimin e pagës së ankuesit me koeficient (7), ka vepruar në pajtim me nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës”*, respektivisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë e obliguar që të bëjë kompensimin e pagës sipas Akt Emërimit pa afat të datës 31.03.2016 ku është paraparë që ankuesi ta realizoj të drejtën e pagës sipas koeficientit shtatë (7).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu duke analizuar provat e lëndës konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit është në kundërshtim me nenin 7, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se, *“2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”* andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ndryshimet në grada për secilin vend të punës propozohen nga

institucioni përkatës në këtë rast Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit , ndërsa aprovohen nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi kritere të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj institucionet me rastin e ngritjes së koeficientit, duhet të respektojnë dispozitat ligjore, rregullat dhe parimet sipas legjislacionit në fuqi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës***  
***Lënda Nr. A. Nr.274/2020***

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Malsore Gashi Bajraktari**

Kryetare e Kolegjit

***Vendimi i dërgohet:***

- Ankuesit ██████████
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Zhvillimit Ekonomik ;
- Arkivit të KPMSHCK-së